UDHËZIM
Nr. 3, datë 10.7.2003

.

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.1, DATË 1.1.1996 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PROKURIMIN PUBLIK", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 5 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.1, datë 1.1.1996 të Këshillit të Ministrave "Për prokurimin publik", i ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- Pika 3 kapitulli I "Enti prokurues dhe urdhri i prokurimit" ndryshon si më poshtë vijon:

"3. Përcaktimi i fondit limit argumentohet nga enti prokurues dhe bëhet në bazë të çmimeve të publikuara nga INSTAT-i dhe institucionet e tjera shtetërore përkatëse. Për çmimet e papublikuara, përcaktimi i fondit limit të bëhet në mbështetje të përvojës së mëparshme të entit prokurues ose sipas testimit të tregut.".

- Në kapitullin II "Procedurat e prokurimit" bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Pika 1 ndryshon si më poshtë vijon:

"1. Procedura e prokurimit përcaktohet në mbështetje të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik" dhe të vendimeve të Këshillit të Ministrave.".

- Në shkronjën "a", "Procedurat e tenderave të hapur dhe ndërkombëtarë" pika 2 bëhen këto ndryshime:

Në paragrafin e parë dhe të dytë të kësaj pike fjala "…kombësia…" zëvendësohet me "…shtetësia.".

Paragrafi i katërt ndryshon si më poshtë vijon:

"Kjo procedurë të përdoret gjithnjë, kur me anë të saj mund të arrihet një konkurrencë e efektshme, sipas kufijve monetarë të përcaktuar në vendimet e Këshillit të Ministrave. Në rast të kundërt, të kalohet në procedura ndërkombëtare, sipas nenit 41 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik."".

- Në shkronjën "b" "Procedurat e parakualifikimit" pika 2, bëhen këto ndryshime:

Paragrafi i tretë ndryshon si më poshtë vijon:

"Kjo procedurë, gjithashtu, i jep mundësinë entit prokurues t'u dërgojë ftesa për paraqitjen e ofertave tekniko-ekonomike vetëm shoqërive të parakualifikuara, të cilat kanë aftësitë dhe burimet e mjaftueshme për të konkurruar, duke kufizuar numrin e shoqërive që do të paraqesin oferta (pas parakualifikimit).".

Paragrafi i pestë ndryshon si më poshtë vijon:

"Në dokumentet e parakualifikimit kërkohet që pjesëmarrësit të plotësojnë të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 12/1 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik."".

Pas paragrafit të gjashtë shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"Për paraqitjen e ofertës tekniko-ekonomike, sipas gjykimit të entit prokurues dhe në varësi të objektit të prokurimit, afati të jetë 10 deri në 20 ditë.".

- Në shkronjën "c" "Tenderi me dy faza", pika 2 të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Në paragrafin e dytë pas fjalës "…kjo…" shtohet fjala "…procedurë…".

Paragrafi i fundit ndryshon si më poshtë vijon:

"Faza e parë e tenderit me dy faza mund të bëhet e hapur ose e kufizuar, në mbështetje të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik" dhe të vendimeve të Këshillit të Ministrave, duke respektuar kufijtë monetarë dhe afatet kohore të përcaktuara në vendim. Faza e dytë e tenderit me dy faza të respektojë kufijtë kohorë të tenderit të kufizuar"."

- Në shkronjën "d" "Kërkesës për kuotim", pika 2 bëhen këto ndryshime:

Paragrafi i tretë shfuqizohet.

Në paragrafin e fundit shprehja "…më shumë se dy…" zëvendësohet me shprehjen "…jo më pak se tre…".

- Në kapitullin III "Dokumentet e tenderit" bëhen këto ndryshime:

Në paragrafin e parë shprehja "…sigurimin e kontratës…" zëvendësohet me "…formularin e sigurimit të kontratës…" dhe pas shprehjes "…njoftimin e fituesit…" shtohen shprehjet "…formulari i kontratës…" dhe "…formulari i autorizimit të prodhuesit…"

Pika 1 e paragrafit të dytë "Për prokurimin e ndërtimeve" ndryshon si më poshtë vijon:

"1. - projektet e zbatimit dhe specifikimet teknike;

- preventivi;

- grafiku për kryerjen e ndërtimeve.".

Në pikën 2 të paragrafit të tretë "Për prokurimin e mallrave" shprehja "…kriteret e vlerësimit…" shfuqizohet.

Pika 3 e paragrafit të katërt "Për prokurimin e shërbimeve të projektimit" ndryshon si më poshtë vijon:

"3. - termat e referencës;

- grafiku i zbatimit;

- kërkesat për personelin kryesor;

- skedari i tarifave, kostove dhe shpenzimeve, nëse kërkohet…".

Në paragrafin e parë "Ftesa për oferta" të shkronjës "a" "Pjesa e përgjithshme" fjala "…çmimin…" zëvendësohet me "…vleftën…".

Në paragrafin e dytë tek "Udhëzimet për pjesëmarrësit në tender" të shkronjës "a" "Pjesa e përgjithshme", në fund të fjalisë së parë, pas fjalës "…ndryshime…" shtohen fjalët "…në to…".

Në paragrafin e pestë tek "Udhëzimet për pjesëmarrësit në tender" të shkronjës "a" "Pjesa e përgjithshme", në fjalinë e dytë përpara shprehjes "…28 ditëve…" shtohet emërtimi "…Bankës së Shqipërisë…".

Pjesa "Formulari i sigurimit të ofertës" e shkronjës "a" "Pjesa e përgjithshme" ndryshon si më poshtë vijon:

"Formulari i sigurimit të ofertës shërben për të mbrojtur entin prokurues nga ofertat e papërgjegjshme. Formulari i sigurimit të ofertës të ketë formën e një depozite a garancie, të lëshuar nga një bankë ose nga shoqëritë e licencuara nga shteti për këtë qëllim. Sigurimi i ofertës u çngurtësohet menjëherë ofertuesve të pasuksesshëm, ndërsa kandidatëve të tjerë u kthehet pas lidhjes së kontratës.".

Në paragrafin e parë të pikës 1 "Për prokurimin e ndërtimeve" të shkronjës "b" "Pjesa e veçantë", fjala "…sipërmarrjet…" zëvendësohet me "…prokurimin…"

Në paragrafin e dytë dhe të tretë të pikës 1 "Për prokurimin e ndërtimeve" të shkronjës "b" "Pjesa e veçantë", fjala "…sipërmarrjet…" zëvendësohet me "…ndërtimet…".

Pika 3 e paragrafit të pestë të pikës 1 "Për prokurimin e ndërtimeve" të shkronjës "b" "Pjesa e veçantë" ndryshon si më poshtë vijon:

"3. Kontratat dhe aktet e tyre të kolaudimit përfundimtar, për objekte të ngjashme, të realizuara gjatë veprimtarisë së shoqërisë në tre vitet e fundit, ku të paktën vlera e një objekti të jetë më e vogël se 50 për qind e vlerës së objektit që prokurohet.".

Paragrafi i gjashtë, i pikës 1 "Për prokurimin e ndërtimeve" të shkronjës "b" "Pjesa e veçantë", ndryshon si më poshtë vijon:

"Nëse sipërmarrësi plotëson të gjitha kërkesat për kualifikim dhe specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, vlerësohet për çmimin (dhe afatin, nëse është parashikuar si kriter vlerësimi në dokumentet e tenderit), që paraqet në ofertën ekonomike, ku si çmim do të merret vlera e plotë e preventivit.".

Paragrafët e nëntë dhe të dhjetë të pikës 1 "Për prokurimin e ndërtimeve" të shkronjës "b" "Pjesa e veçantë" zëvendësohen me fjalinë "Kriter vlerësues do të jetë çmimi më i ulët.".

Paragrafi i gjashtë i pikës 2 "Për mallrat" të shkronjës "b" "Pjesa e veçantë" ndryshon si më poshtë vijon:

"Në rastet kur kriteret e vlerësimit janë më shumë se një dhe në varësi të objektit të prokurimit, kritere të tjera që mund të merren parasysh janë: shpenzimet për transportin e brendshëm dhe sigurimin deri në vendin e dorëzimit, grafiku i pagesave, koha e livrimit, shpenzimet operative, efektiviteti dhe përshtatshmëria e pajisjeve, si dhe gatishmëria e shërbimeve dhe e pjesëve të këmbimit etj. Për të gjithë këta faktorë, veç çmimit, që do të përdoret për të përcaktuar ofertën më të leverdisshme, enti prokurues duhet të përcaktojë metodologjinë e vlerësimit për secilin kriter të shprehur në vlerë monetare.".

Paragrafi i tretë i pikës 3 "Për shërbimet" të shkronjës "b" "Pjesa e veçantë" ndryshon si më poshtë vijon:

"Në rastet kur kriteret e vlerësimit janë më shumë se një dhe në varësi të objektit të prokurimit, kritere të tjera që mund të merren parasysh janë: përvoja e mëparshme, personeli që do të kryejë këtë shërbim etj. Për të gjithë këta faktorë, veç çmimit, që do të përdoret për të përcaktuar ofertën më të leverdisshme, enti prokurues duhet të përcaktojë metodologjinë e vlerësimit për secilin kriter të shprehur në vlerë monetare.".

Në pikën 3 "Për shërbimet" të shkronjës "b" "Pjesa e veçantë" paragrafët i tretë dhe i katërt shfuqizohen.

- Në kapitullin IV "Komisioni i vlerësimit të ofertave dhe njësia e prokurimit (Hartuesit e dokumenteve të tenderit)" bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Në paragrafin e pestë pas fjalës "…prokurimeve…" shtohet shprehja "…të mësipërme…"

Paragrafi i trembëdhjetë ndryshon si më poshtë vijon:

"Për tenderat kombëtarë afati i dorëzimit të ofertave të jetë afati i përcaktuar në dokumentet e tenderit.".

Në paragrafin e katërmbëdhjetë fjala "…ose…" zëvendësohet me "…dhe…".

Paragrafi i gjashtëmbëdhjetë ndryshon si më poshtë vijon:

"Ofertat e paraqitura nga kandidatët merren në dorëzim nga komisioni i vlerësimit të ofertave, i cili bën pranimin e tyre, dhe në prani të ofertuesve hidhen në një kuti të veçantë, që vendoset në një vend të dukshëm. Më pas komisioni i vlerësimit të ofertave të procedojë me hapjen e ofertave.".

Paragrafët i shtatëmbëdhjetë, i tetëmbëdhjetë, i nëntëmbëdhjetë dhe i njëzet zëvendësohen me paragrafët me këtë përmbajtje:

"Pas hapjes së ofertave të paraqitura nga ofertuesit, njëri nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave lexon me zë të lartë emrin e ofertuesit, dokumentacionin administrativo-ligjor kualifikues dhe vleftën totale të çdo oferte, si dhe i regjistron në procesverbal, i cili hartohet në mbështetje të nenit 31/3 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 " Për prokurimin publik".

Enti prokurues të shqyrtojë të gjitha dokumentet e paraqitura në çdo ofertë për të konfirmuar nëse ato janë në përputhje të plotë me dokumentet e tenderit dhe për të përcaktuar plotshmërinë e çdo dokumenti të paraqitur. Nëse njëri prej dokumenteve të kërkuar mungon ose është i paplotë oferta refuzohet.

Enti prokurues të shqyrtojë çdo ofertë për të konfirmuar se ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe se i përmbush të gjitha afatet dhe kushtet. Oferta, që është në përputhje me të gjitha kërkesat duke përfshirë afatet dhe kushtet, konsiderohet e vlefshme.

Enti prokurues të vlerësojë dhe krahasojë ofertat e kualifikuara si të vlefshme, me qëllim që të përcaktojë ofertën fituese në përputhje me procedurat dhe kriteret e paraqitura në dokumentet e tenderit. Asnjë kriter tjetër nuk do të përdoret nëse nuk parashikohet në dokumentet e tenderit.".

Paragrafi i njëzet e dytë shfuqizohet.

Në paragrafin e njëzetepestë fjala "…kandidati…" zëvendësohet me shprehjen "…ofertuesi fitues…".

Në paragrafin e njëzetetetë shprehja "…rregullave të prokurimit publik, të përcaktuara me vendimin e Këshillit të Ministrave…" zëvendësohet me shprehjen "…mënyrës dhe kohës që parashikohet në ligjin për arkivat dhe ligjin për informimin publik.".

Paragrafi i tridhjetë ndryshon si më poshtë vijon:

"Komisioni i vlerësimit të ofertave bën klasifikimin përfundimtar të ofertave, i cili nënshkruhet nga kryetari i komisionit, dhe ua njofton atë zyrtarisht ofertuesve.".

- Në kapitullin V "Ankimi administrativ" bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Në paragrafin e tretë shprehja "…10 ditësh…" zëvendësohet me"…5 ditësh…".

Në fund të kapitullit shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"Ofertuesi që nuk është dakord me përgjigjen e entit prokurues ka të drejtë të ankohet sipas pikës 3 të nenit 44 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik.".

- Në kapitullin VI "Miratimi" bëhet ky ndryshim:

Paragrafi i gjashtë shfuqizohet.

- Në kapitullin VII "Të përgjithshme" bëhen këto ndryshime:

Paragrafi "Procedurat që ndiqen në rast të mossigurimit të konkurrencës" ndryshon si më poshtë vijon:

"Procedurat e prokurimit të përsëriten për procedurën "Tender i hapur" kur:

- paraqitet vetëm një ofertë;

- pas shqyrtimit të ofertave, mbetet vetëm një ofertë e vlefshme.

Procedurat e prokurimit të përsëriten për procedurën "Tender i kufizur" dhe "Kërkesë për kuotim" kur:

- paraqiten jo më pak se tri oferta;

- ofertat nuk i plotësojnë kërkesat për kualifikim dhe specifikimet tekniko-ekonomike dhe në garë mbeten më pak se tre ofertues.".

Paragrafi i fundit zëvendësohet me paragrafin me këtë përmbajtje:

"Dokumentet standarde të tenderit për mallrat, ndërtimet dhe shërbimet dhe manuali i përdoruesit miratohen bashkë me këtë udhëzim. Dokumentet standarde të tenderit, që i bashkëlidhen udhëzimit nr.1, datë 1.1.1996 të Këshillit të Ministrave "Për prokurimin publik", i ndryshuar, shfuqizohen.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano